



INVESTIGATIVE NETWORK ALBANIA

**Komunikimi dhe Vizibiliteti në
aktivitetet e financuara nga
Investigative Network Albania**

Kërkesa për partnerët zbatues
(Projektet/Programet/Artikujt)

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE

- a- Iniciativa "FIND Albania"
- b- Platforma e gazetarisë investigative

2. PLANIFIKIMI I KOMUNIKIMIT DHE VIZIBILITETIT

- 2.1 Kriteret e planifikimit
 - 2.1.1 Kriteret e komunikimit dhe vizibilitetit
 - 2.1.2 Brandimi
- 2.2 Plani i komunikimit dhe vizibilitetit
- 2.3 Vizibiliteti i FIND Albania pas përfundimit të fazës së financuar nga Partnerët

3. ZBATIMI I KOMUNIKIMIT DHE VIZIBILITETIT

- 3.1 Komunikimi dhe vizibiliteti në internet
 - 3.1.1 Faqet e internetit
 - 3.1.2 Mediat sociale
 - 3.1.3 Buletinet elektronike, artikujt në internet dhe blogjet
- 3.2 Fushatat e informimit, evenimentet/aktivitetet, vizitat, takimet e palëve të interesuara
- 3.3 Materialet audiovizuale, fotografitë dhe produktet e tjera
 - 3.3.1 Videot
 - 3.3.2 Audiot
 - 3.3.3 Fotografitë
 - 3.3.4 Tipe të tjera prodhimi
- 3.4 Të drejtat e pronësisë intelektuale
 - 3.4.1 E drejta e Partnerëve për të përdorur rezultatet e komunikimit dhe të drejtat para-ekzistuese
 - 3.4.2 Të drejtat morale të krijuesve
 - 3.4.3 Të drejtat e imazhit dhe regjistrimet e zërit
 - 3.4.4 Njoftimi mbi të drejtën e autorit

4. RAPORTIMI

- 4.1 Raportimi mbi komunikimin dhe vizibilitetin
- 4.2 Vizibiliteti i raporteve

5. ÇËSHTJE LIGJORE

- 5.1 Përjashtime nga kërkesat e vizibilitetit
- 5.2 Rregullat e identitetit vizual të INA
- 5.3 Deklaratat e mospërgjegjësisë
- 5.4 Vizibiliteti në strukturat me shumë donatorë

1.HYRJE

1. HYRJE

“FIND Albania: Fuqizimi i Gazetarëve Hetues në Luftimin e Korrupsionit dhe Abuzimit të Pushtetit” është një iniciativë e mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë, dhe e zbatuar bashkarisht nga Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore, Instituti Shqiptar i Medias dhe Qendra FOL (Partnerët), në një periudhë kohore prej 18 muaj, me synimin e mbështetjes së peisazhit mediatic dhe profesionistëve të pavarur në këtë fushë, për të zgjeruar pikëpamjet e tyre dhe për të paraqitur një kontekst pluralist që rrit transparencën dhe llogaridhënien, si dhe nxjerr në pah korrupsionin.

Iniciativa planifikon të zbatojë 3 aktivitete thelbësore në të gjitha rajonet e Shqipërisë: (1) ngritja e një Platforme të Gazetarisë Hulumtuese e titulluar (Databaza e Lajmeve Hulumtuese), (2) vënia në dispozicion e Granteve për Gazetarët Individual, dhe (3) vënia në dispozicion e Granteve të Vogla dhe të Mesme për organizatat mediatike jo fitimprurëse dhe stacionet televizive.

Platforma e Gazetarisë Investigative (Databaza e Lajmeve Hulumtuese)

Platforma në internet do të shërbejë si një hapësirë alternative informacioni për shoqërinë shqiptare, që prodhon përmbajtje të pavarur dhe profesionale. Të gjitha historitë hulumtuese dhe informacionet e tjera të lidhura me projektin do të ndahen në këtë faqe. Kjo e fundit do të përdoret gjithashtu si një mjet për shpërndarjes së mesazhit.

Platforma do të ketë një hapësirë të dedikuar për secilën formë të prodhimit, nga artikujt hulumtues të formës së gjatë, tek ato që integrojnë komponentë multimedialë si grafikë, tabela me histori, video montazhe, një hapësirë e dedikuar për prodhime video si dhe programe televizive që do të transmetohen gjithashtu dhe në platformat e përfutuesve të mbështetjes financiare.

Një element tjetër që do të përfshihet në platformë, i ri për mjedisin mediatic shqiptar, është shërbimi i formatit Web-Gis, i cili do të sigurojë hartëzimin e artikujve në kontekstin lokal. Përtej kategorizimit të artikujve në sektorë të veçantë si ekonomi, sociale, dosje, krim, korrupsion, etj., lexuesit / shikuesit do të kenë mundësinë e hyrjes në një hartë të integruar në faqen e internetit, e cila do të tregojë historitë dhe prodhimet e tjera botuar në një nivel rajonal përmes nënmenuve specifike.

Qëllimi i përgjithshëm i këtyre Kërkesave për Komunikim dhe Vizibilitet është të sigurojnë që çdo komunikim mbi veprimet e jashtme të financuara nga projekti "FIND Albania" përputhet me vlerat dhe prioritetet e Partnerëve. Në mënyrë të veçantë, Kërkesat janë hartuar për të siguruar që veprimet e jashtme që janë të financuara tërësisht ose pjesërisht nga Partnerët, përfshijnë masa informimi dhe komunikimi të hartuara për të informuar audiencën të synuar specifike ose të përgjithshme mbi arsyet e veprimit dhe mbi rezultatet dhe ndikimin e kësaj mbështetjeje.

Kërkesat e listuara në këtë dokument zbatohen kryesisht për projekte, si grantet e financuara nga Partnerët, shërbimet, materialet e broshuara në kuadër të projektit FIND Albania, si dhe çdo botim, i cili financohet dhe do të botohet në Platformën e Shkrimeve Investigative. Partnerët që zbatojnë veprime të tilla të jashtme të financuara janë përgjegjës për publikimin e këtyre veprimeve dhe, më në përgjithësi, mbështetjes së ofruar nga Partnerët.

Ky dokument përshkruan detyrimet ligjore të partnerëve dhe elementët e detyrueshëm të masave të komunikimit dhe vizibilitetit që duhet të shoqërojnë të gjitha veprimet e jashtme të financuara nga projekti FIND Albania. Përveç, nëse marrëveshjet dhe kontratat në fjalë parashikojnë shprehimisht ndryshe, ai përbën një kuadër të detyrueshëm kontraktues të zbatueshëm për të gjitha marrëveshjet dhe kontratat e financimit (duke përfshirë ato të lidhura me nënkontraktuesit), të cilat u referohen Kërkesave, pavarësisht nga autoriteti kontraktues.

2.PLANIFIKIMI I KOMUNIKIMIT DHE VIZIBILITETIT

2. PLANIFIKIMI I KOMUNIKIMIT DHE VIZIBILITETIT

2.1 Kriteret e planifikimit

2.1.1 Kriteret e komunikimit dhe vizibilitetit

Masat e Komunikimit dhe Vizibilitetit që shoqërojnë veprimet e financuara nga FIND ALBANIA:

a) duhet të ndërtohen si pjesë e një plani të strukturuar komunikimi dhe vizibiliteti hartuar nga partneri përkatës, që përmban elementet e mëposhtëm:

- një objektiv të qartë komunikimi;
- audienca të synuara të mirëpërcaktuara;
- mesazhe kyçe të harmonizuara me objektivat e përgjithshme të FIND ALBANIA (dhe aty ku është e mundur strategji komunikimi);
- një afat kohor;
- një buxhet;
- kanale komunikimi të përshtatshme për kontekstin;
- tregues për monitorimin dhe vlerësimin e suksesit dhe shtrirjes së aktiviteteve K&V;
- një pikë fokale të përcaktuar K&V.

b) duhet të përdorin informacion të saktë dhe të bazuar në fakte;

c) duhet të jenë të planifikuara dhe të renditura siç duhet, por, gjithashtu, të shfrytëzojnë sa më mirë çdo mundësi të përshtatshme që mund të lindë;

d) duhet të përqendrohen te njerëzit, duke miratuar, aty ku është e përshtatshme, një përjasje rrëfyese që thekson më tepër ndikimin e veprimit në jetët individuale, sesa momentet kyçe apo buxhetet administrative;

e) duhet të lejojnë kontekstin, zakonet dhe praktikat vendore, por pa kompromentuar vlerat dhe parimet themelore të FIND ALBANIA;

f) duhet të përdorin gjuhën (gjuhët) vendore aty ku është e mundur;

g) duhet të jenë të përshtatshme për kanalet e përdorura (p.sh. mediet sociale) dhe audiencën e synuar (p.sh. të rinjtë) në aspektin e stilit dhe regjistrimit;

h) duhet të jenë në proporcion me shkallën e veprimit në fjalë në aspektin kosto-përfitim;

i) duhen të shfrytëzohen, aty ku është e përshtatshme, përmes partneriteteve me individë dhe organizata me një efekt të mundshëm shumëzues;

j) duhet të koordinohen ngushtësisht me Partnerët, me veprime të tjera të financuara nga FIND ALBANIA;

Mjeti i përdorur për të përcaktuar, analizuar dhe artikulluar këta faktorë për qëllime kontraktuale është plani i komunikimit dhe vizibilitetit (seksioni 2.2).

2.1.2 Brandimi

Emblema e Investigative Network Albania (INA) (seksioni 5.2) është marka vizuale e paracaktuar që përdoret për të njohur dhe reklamuar mbështetjen financiare të Partnerëve për një veprim të jashtëm.

Asnjë markë tjetër vizuale, pa miratimin paraprak të Partnerëve, nuk mund të përdoret për këtë qëllim. Përgjashtimet mund të autorizohen vetëm në raste shumë të rralla dhe vetëm sipas gjykimit të Bashkimit Evropian. Të gjitha këto përgjashtime kërkojnë marrëveshjen paraprake me shkrim të Partnerëve.

Bashkarisht me përdorimin e emblemës së INA, duhet njohur kontributi financiar i Partnerëve me fjalët: *"Financuar (ose "Bashkëfinancuar", sipas rastit) nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë dhe Partnerët në Projekt"*. Nëse konsiderohet e rëndësishme për audiencën e synuar dhe efektive në lidhje me shtrirjen dhe angazhimin, partnerët zbatues mund të krijojnë logo të dedikuara ose shenja të tjera vizuale për të identifikuar veprime të jashtme specifike të financuara nga Partnerët. Aty ku logo të tilla dhe titujt e veprimeve në fjalë përdoren së bashku me emblemën e INA, emblema e INA duhet të jetë e dallueshme dhe e ndarë dhe nuk mund të përzihet apo të modifikohet me ndonjë shenjë, markë ose tekst tjetër vizual. Partnerët që krijojnë logo të dedikuara për programin ose shenja të tjera vizuale identiteti për përdorim së bashku me emblemën e INA janë përgjegjës për të siguruar që janë marrë të gjitha masat e nevojshme në lidhje me çdo të drejtë të pronësisë intelektuale që ka lidhje me këtë.

2.2 Plani i komunikimit dhe vizibilitetit

Komunikimi ndodh gjatë gjithë ciklit të projektit dhe veprimet dhe produktet e komunikimit dhe vizibilitetit duhet të renditen me kujdes për të arritur ndikimin maksimal.

Përveç kur është rënë dakord në mënyrë të shprehur ndryshe me Partnerët, partnerët duhet të prodhojnë një plan komunikimi dhe vizibiliteti (PKV) për veprimin që po zbatojnë, si dhe të marrin miratimin e Partnerëve për të, që nga fillimi i zbatimit të aktiviteteve operative.

PKV-të për të gjitha veprimet, duke përfshirë veprimet rajonale dhe ato në të cilat burimet e komunikimit dhe vizibilitetit janë bashkuar, duhet të përpqen t'i maksimizojnë sinergjitë me strategjinë përkatëse të përgjithshme të komunikimit të Partnerëve.

Të gjitha aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit, si dhe produktet e përfshira në plan, duhet të jenë në përputhje me kriteret për komunikimin e duhur të paraqitura në seksionin 2.1.1.

Niveli i detajeve në plan duhet të jetë në përpjesëtim me natyrën, qëllimin dhe koston e aktiviteteve të komunikimit dhe vizibilitetit, si dhe të produkteve të parashikuara. PKV duhet të përfshijë një buxhet. Komunikimi efektiv mbi mbështetjen e Partnerëve është një komponent thelbësor i zbatimit dhe të gjitha marrëveshjet e financimit dhe të delegimit, si dhe kontratat e granteve, duhet të përfshijnë një dispozitë specifike buxhetore për aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit që është në përpjesëtim të drejtë me shkallën, kontekstin dhe natyrën e veprimit të propozuar.

Modeli i detyrueshëm PKV duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm:

Objektivat

1. Objektivin (objektivat) e komunikimit
2. Grupet e synuara
3. Mesazhet kryesore nga grupi i synuar (në lidhje me objektivat operative të veprimit)

Aktivitetet

4. Mjetet dhe kanalet e identifikuara të komunikimit
5. Aktivitetet kryesore të parashikuara të komunikimit dhe programin indikativ

Vlerësimi

6. Treguesit sipas objektivit / grupit të synuar
7. Mjetet e verifikimit / reagimit

Burimet

8. Burimet njerëzore: pikë fokale e komunikimit
9. Burimet financiare: buxheti i disponueshëm për aktivitetet e komunikimit

2.3 Vizibiliteti i FIND Albania pas përfundimit të fazës së financuar nga Partnerët

Kur veprimet vazhdojnë pas përfundimit të fazës së financuar nga Partnerët, emblema e INA nuk do të përfshihet në asnjë aktivitet të ri komunikimi që shoqëron veprimin pasi kanë kaluar gjashtë muaj pas përfundimit të fazës së financuar nga Partnerët. Përfshirjet e vetme janë pllakat përkujtimore dhe panelet ekspozuese.

Megjithatë, materialet e komunikimit të nxjerra për veprimin pasi ka kaluar periudha gjashtëmujore duhet të përfshijnë fjalinë e mëposhtme: "*Një fazë e hershme e këtij projekti / programi (<data 1 - data 2>) u mbështet nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë dhe Partnerët në Projekt*". Kjo frazë duhet të shfaqet po aq dukshëm sa dhe vizibiliteti që i jepet kontributit të Partnerëve në fazën e financuar nga ky i fundit.

3.ZBATIMI I KOMUNIKIMIT DHE VIZIBILITETIT

Faza të ndryshme të ciklit të projektit mund të kërkojnë produkte të ndryshme komunikimi dhe vizibiliteti. Seksionet e mëposhtme përmbajnë udhëzime për përdorimin e një game kanalesh, mjetesh, aktiviteteve dhe produkteve të komunikimit dhe vizibilitetit. Sidoqoftë, në një fushë që vazhdon të zhvillohet në mënyrë dinamike, është e pamundur të mbulohen të gjitha rastësitë dhe masat K&V si rregull i përgjithshëm duhet të hartohen në përputhje me praktikën më të mira, me logjikën, si dhe në konsultim me Partnerët.

3.1 Komunikimi dhe vizibiliteti në internet

Informacioni rreth veprimeve të jashtme të financuara nga Partnerët shpërndahet përmes faqeve zyrtare, platformave të internetit dhe llogarive të medieve sociale të këtij të fundit. Me kërkesën e Partnerëve, partnerëve zbatues u kërkohet të japin përmbajtje dhe pamje vizuale të formatuara në mënyrë të përshtatshme për publikim në faqet përkatëse të internetit dhe në adresa të medieve sociale.

Partnerët duhet të përfshijnë informacion në lidhje me veprimet e financuara nga Partnerët që ata janë duke zbatuar në faqet e tyre të internetit dhe në llogaritë e medieve sociale, të cilat duhet të paraqesin dukshëm emblemën e INA, të shoqëruar me tekstin që njih mbështetjen e Partnerëve (seksioni 2.1.2), si dhe të përmbajnë lidhje me faqet përkatëse të internetit të Partnerëve dhe me llogaritë e medieve sociale.

3.1.1 Faqet e internetit

Nëse, përveç paraqitjes së informacionit mbi veprimet e financuara nga Partnerët në faqet e tyre të internetit, partnerët zbatues dëshirojnë të krijojnë faqe interneti të dedikuara, të drejtuar nga jashtë (p.sh., me adresa URL jashtë domenit të tyre) për veprime të jashtme specifike të financuara nga Partnerët, faqe të tilla interneti duhet të jenë në përputhje me kriteret e përshtatshme për komunikimin dhe vizibilitetin të përcaktuara në seksionin 2.1. Ato duhet të paraqesin dukshëm emblemën e INA të shoqëruar me tekstin që njih mbështetjen e Partnerëve (seksioni 2.1.2), lidhje me faqet përkatëse të internetit të Partnerëve, si dhe një deklaratë mospërgjegjësie (seksioni 5.3).

Partnerët duhet të sigurojnë që informacioni i ofruar nga faqe të tilla të jetë i përditësuar dhe që të gjitha lidhjet e paraqitura funksionojnë si duhet. Kur veprimet e financuara nga Partnerët përfundojnë, partnerët duhet të sigurojnë që faqe të tilla tregojnë se ato nuk janë më aktive apo të përditësuara. Kur veprimet vazhdojnë pa fonde nga Partnerët, partnerët duhet t'u përmbahen udhëzimeve të dhëna në seksionin 2.3.

Kur veprimet e jashtme të financuara nga FIND ALBANIA -ja përfundojnë, partnerët zbatues duhet t'i vënë të gjitha materialet dhe dokumentacionin kryesor të krijuar nga veprimi (foto, video dhe rezultate teknike, studime dhe materiale trajnimi) në dispozicion të Partnerëve në një format të përshtatshëm.

3.1.2 Mediet sociale

Në qoftë se, përveç paraqitjes së informacionit mbi veprimet e financuara nga Partnerët në llogaritë e tyre të brendshme të medieve sociale, partnerët zbatues dëshirojnë të krijojnë llogari të dedikuara të medieve sociale për veprime të jashtme specifike të financuara nga

Partnerët, këto adresa duhet të jenë në përputhje me kriteret e përshtatshme për komunikim dhe vizibilitet të përcaktuara në seksionin 2.1, si dhe me praktikën më të mira për kanalin e medie sociale në fjalë. Ato duhet t'u përkasin dukshëm veprimeve të mbështetura, të jenë drejtpërdrejtë të gjurmueshme, si dhe të paraqesin dukshëm emblemën e INA të shoqëruar me tekstin që njih mbështetjen e Partnerëve (seksioni 2.1.2), lidhjet me llogaritë përkatëse të medie sociale dhe faqeve të internetit të FIND ALBANIA -së, si dhe një deklaratë mospërgjegjësie (neni 5.3).

Partnerët duhet të sigurojnë që informacioni i dhënë nga këto llogari është i përditësuar dhe që të gjitha lidhjet e paraqitura funksionojnë si duhet. Kur veprimet e jashtme të financuara nga Partnerët me llogari të dedikuara të medie sociale përfundojnë, partnerët zbatues duhet të sigurojnë që ato llogari tregojnë qartë (p.sh., në përshkrimin e profilit) se nuk janë më aktive apo të përditësuara. Kur veprimet vazhdojnë pa fonde nga Partnerët, partnerët duhet t'u përmbahen udhëzimeve të dhëna në seksionin 2.3.

3.1.3 Buletinet elektronike, artikujt në internet dhe blogjet

Partnerët që prodhojnë dhe shpërndajnë buletine elektronike, artikujt në internet dhe postime në blogje për të informuar audiencat e palëve të interesuara rreth veprimeve të jashtme të financuara nga Partnerët duhet t'u përmbahen kriterëve për komunikimin dhe vizibilitetin të përcaktuara në seksionin 2.1 të këtij Udhëzuesi, si dhe me praktikën më të mirë për kanalin e komunikimit në fjalë.

Një deklaratë mospërgjegjësie (seksioni 5.3) duhet të tregojë qartë se buletini, artikulli në internet ose postimi në blog në fjalë nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjen e Partnerëve dhe të Ambasadës së Shteteve të bashkuara në Tiranë.

3.2 Fushatat e informimit, evenimentet, vizitat, takimet e palëve të interesuara

Fushatat e informimit, evenimentet, vizitat e profilit të lartë dhe mbledhjet e palëve të interesuara u nënshtrohen kriterëve të përshtatshme për komunikimin dhe vizibilitetin të përcaktuara në seksionin 2.1 të këtyre Kërkesave. Për përdorimin e motive, sloganeve dhe logove, shih seksionin 2.1.2.

Fushatat

Fushatat e informimit të kryera nga partnerët që zbatojnë veprime të financuara nga Partnerët, të cilat lidhin objektivat operative të këtyre veprimeve me objektivat e përgjithshme të projektit FIND Albania në vendin apo rajonin në fjalë ose që nxjerrin në pah arritjet e veprimeve të caktuara apo partneritetin e përgjithshëm të FIND Albania, duhet të miratohen nga Partnerët dhe të koordinohen me të.

Evenimentet, vizitat

Evenimentet publike (siç janë konferencat, seminarët, debatet, kurset e trajnimit, panairët dhe ekspozitat) të financuara nga një buxhet i caktuar K&V i një projekti të financuar nga Partnerët për të publikuar objektivat ose arritjet e veprimit duhet të miratohen nga Partnerët dhe të koordinohen me të, edhe nëse evenimenti është organizuar ose jo drejtpërdrejt nga partneri zbatues.

Emblema e INA (seksioni 5.2.) duhet të shfaqet dukshëm në materialet, në internet, si dhe në vendtakime, për të siguruar që njerëzit që ndjekin këto evenimente janë të vetëdijshëm për mbështetjen financiare të Partnerëve. Emblemat e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë është e ndaluar të përdoren.

3.3 Materialet audiovizuale, fotografitë dhe produktet e tjera

Materiali audiovizual dhe fotografik duhet të përputhet me kriteret e përshtatshme për komunikimin dhe vizibilitetin të përcaktuara në seksionin 2.1, si dhe me standardet dhe praktikat më të mira të njohura përgjithësisht në fushën në fjalë.

Partnerët ka të drejtë të përdorë ose të riprodhojë të gjitha materialet audiovizuale dhe fotografike të prodhuara duke përdorur fondet e projektit FIND Albania, siç përshkruhet në seksionin 3.4 mbi të drejtat e pronësisë intelektuale. Kërkesa të mëtejshme për produkte specifike të komunikimit dhe vizibilitetit paraqiten më poshtë.

3.3.1 Videot

Videot e prodhuara nga veprimet e jashtme të financuara nga Partnerët duhet të miratohen nga Partnerët përpara se të shfaqen, transmetohen apo shpërndahen. Ato duhet të paraqesin emblemen e INA në fillim dhe/ose në fund të produksionit, shoqëruar me tekstin në vijim:

“Ky [film / video / ...] u prodhua me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë dhe Partnerëve”.

Duhet përfshirë edhe deklarata mospërgjegjësie, siç tregohet në seksionin 5.3.

Partnerët zbatues duhet të sigurojnë që të gjitha produksionet e videove të tilla t'i vihen në dispozicion Partnerëve në formatin e specifikuar sipas kontratës, së bashku me gjithë informacionet në lidhje me transmetimin, shpërndarjen dhe përhapjen e tyre, si dhe me metadatat përkatëse përshkruese në anglisht, duke përfshirë: titullin, përmbledhjen, datat e filmimit dhe produksionit, kompaninë prodhuese, regjisorin dhe versionin (versionet) gjuhësor, plus skenarin dhe skedarët e subtitritimit, nëse janë të disponueshëm. Një format i përcaktuar mbi raportimin e publikimeve do të vihet në dispozicion të partnerëve.

3.3.2 Audiot

Produksionet në radio dhe produksione të tjera audio të prodhuara nga veprimet e jashtme të financuara nga Partnerët duhet të miratohen nga Partnerët para se të transmetohen apo shpërndahen. Ato duhet të përfshijnë frazën e mëposhtme:

“Ky [program / ...] u prodhua me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë dhe Partnerëve”.

Duhet përfshirë edhe deklarata mospërgjegjësie, siç tregohet në seksionin 5.3.

Partnerët zbatues duhet të sigurojnë që kopjet e produksioneve të tilla audio t'i vihen në dispozicion Partnerëve në formatet e përcaktuara sipas kontratës, së bashku me gjithë informacionet që kanë të bëjnë me transmetimin, shpërndarjen dhe përhapjen e tyre, si dhe

me metadatat përshkruese përkatëse në gjuhën angleze, duke përfshirë: titullin, përmbledhjen, datat e regjistrimit dhe produksionit, kompaninë prodhuese, regjisorin dhe versionin (versionet) e gjuhës. Një format i përcaktuar mbi raportimin e publikimeve do të vihet në dispozicion të partnerëve.

3.3.3 Fotografitë

Progresi, rezultatet dhe ndikimi i veprimeve të financuara nga Partnerët dhe evenimentet përkatëse, aty ku është me vend dhe e mundur, duhet të dokumentohen me fotografi për përdorim të mëtjshëm në veprimet dhe produktet e komunikimit.

Një kopje e të gjitha fotografive të prodhuara në kontekstin e veprimeve të jashtme të financuara nga Partnerët duhet t'i vihet në dispozicion Partnerëve në formatin e specifikuar sipas kontratës.

3.3.4 Tipa të tjera produksioni

Për produksione tradicionale dhe produksione dhe veprime me teknologji të ulët K&V që prodhohen duke përdorur fonde të Partnerëve (si teatër, pantomima, rapsodi, kasnecë dhe artistë rruge, buletine, fletpalosje, broshura, ekspozime, banderola etj.), opsionet për promovimin e vizibilitetit të Partneritetit do të përmbahen parashikimeve të përgjithshme të këtij Udhëzuesi, dhe duhen të përcaktohen rast pas rasti në marrëveshje me Partnerët.

3.4 Të drejtat e pronësisë intelektuale

Përgjegjësia e partnerit zbatues për rezultatet e komunikimit

Përveç kur Partnerët ka vendosur ndryshe në mënyrë specifike para fillimit të një veprimi të caktuar, partnerët zbatues mbajnë përgjegjësi të plotë, si dhe të drejtat industriale dhe ato të pronësisë intelektuale, për të gjitha materialet dhe produktet e komunikimit dhe vizibilitetit (K&V) ("rezultatet") e zhvilluara në mbështetje të veprimeve të jashtme të financuara nga Partnerët, të mbuluara nga këto Kërkesa.

3.4.1 E drejta e Partnerëve për të përdorur rezultatet e komunikimit dhe të drejtat para-ekzistuese

Partnerët zbatues i japin Partnerëve një licencë pa tarifa, jo-ekskluzive dhe të përvokueshme për të përdorur të gjitha materialet dhe produktet e komunikimit dhe vizibilitetit ("rezultatet") të zhvilluara në mbështetje të veprimeve të jashtme të financuara nga Partnerët, të mbuluara nga këto Kërkesa, për këto qëllime:

- (a) për përdorim të brendshëm: Partnerët në veçanti ka të drejtën t'ia vërë këto rezultate në dispozicion institucioneve dhe agjencive të ndryshme, dhe për këtë qëllim të kopjojë dhe riprodhojë rezultatet tërësisht ose pjesërisht në një numër të pakufizuar kopjesh;
- (b) për riprodhim: Partnerët kanë të drejtë të autorizojë riprodhimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të përkohshëm ose të përhershëm, të këtyre rezultateve me çdo mjet (mekanik, digjital ose tjetër) dhe në çdo formë, tërësisht ose pjesërisht;
- (c) për komunikim me publikun: Partnerët ka të drejtë të autorizojë çdo paraqitje, shfaqje

ose forma të tjera të komunikimit të këtyre rezultateve të publiku duke përdorur çdo mjet transmetimi, përfshirë me mjete me kablo ose pa kablo, internetin, si dhe komunikim dhe transmetimin kabllor dhe satelitor;

(d) për shpërndarje: Partnerët kanë të drejtë të autorizojë çdo formë shpërndarjeje të këtyre rezultateve - ose kopje të tyre - të publiku;

(e) për përshtatje: Partnerët kanë të drejtë të autorizojë çdo modifikim të këtyre rezultateve;

(f) për përkthim: Partnerët kanë të drejtë të autorizojë çdo përkthim, përshtatje dhe rregullime, krijimin e veprave derivate, si dhe çdo ndryshim tjetër të këtyre rezultateve, me kusht që të respektohen të drejtat morale të autorëve, aty ku është e zbatueshme;

(g) për nën-licencim: Partnerët kanë të drejtë t'u nën-licencojë palëve të treta mënyrat e shfrytëzimit të përcaktuara në pikat (a) deri (f);

(h) për ruajtje dhe arkivim: Partnerët kanë të drejtë t'i ruajë dhe arkivojë këto rezultate në përputhje me rregullat e veta të brendshme të menaxhimit të dokumenteve, përfshirë përmes digjitalizimit ose konvertimit të formatit për qëllime të ruajtjes ose ripërdorimit;

Kjo licencë mbulon të gjitha territoret në mbarë botën dhe është e vlefshme për kohëzgjatjen e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale.

Mënyrat e mësipërme të shfrytëzimit mund të zhvillohen më tej, të detajohen dhe specifikohen në marrëveshje ose kontrata specifike të granteve, të cilat mund të parashikojnë të drejta të tjera të Partnerëve të këtij lloji.

Partnerët zbatues duhet të sigurojnë që të drejtat para-ekzistuese të përfshira në rezultatet e veprimit janë të lira nga pretendimet e krijuesve apo çdo pale tjetër të tretë dhe se Partnerët kanë të drejtë t'i përdorë këto të drejta para-ekzistuese. Të drejtat para-ekzistuese mund të përdoren për të njëjtat qëllime dhe sipas të njëjtave kushte që zbatohen për të drejtat e përdorimit të rezultateve të komunikimit dhe vizibilitetit të veprimit, përveç nëse përcaktohet ndryshe në marrëveshjet e granteve ose në kontratat përkatëse.

3.4.2 Të drejtat morale të krijuesve

Kur japin rezultatet e komunikimit dhe vizibilitetit të një veprimi të jashtëm të financuar nga Partnerët, partnerët zbatues garantojnë që krijuesit në fjalë nuk do të kundërshtojnë sa më poshtë, në bazë të të drejtave të tyre morale sipas së drejtës së autorit:

(a) që emrat e tyre mund të përmenden ose të mos përmenden kur rezultatet t'i paraqiten publikut;

(b) që rezultatet mund të shpërndahen ose jo pasi t'i jenë dorëzuar në versionin e tyre përfundimtar;

(c) që rezultatet mund të përshtaten siç parashikohet në seksionin 3.4.2 të këtyre Kërkesave, me kusht që kjo të bëhet në një mënyrë që nuk dëmton nderin apo reputacionin e krijuesve.

Nëse ekzistojnë të drejta morale për pjesë të rezultateve të mbrojtura me të drejtën e autorit,

partnerët zbatues duhet të marrin pëlqimin e krijuesve të interesuar për të dhënë ose hequr dorë nga të drejtat morale përkatëse në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme, si dhe të sigurojnë dëshmi të dokumentuara për këtë qëllim, me kërkesë.

3.4.3 Të drejtat e imazhit dhe regjistrimet e zërit

Nëse imazhet e personave fizikë, zërat e tyre ose çdo atribut tjetër personal privat paraqiten në mënyrë të njohshme në rezultatet e komunikimit dhe vizibilitetit të një veprimi të jashtëm të financuar nga Partnerët, partnerët zbatues duhet të marrin deklarata nga personat e interesuar (ose, në rastin e të miturve, nga personat që ushtrojnë autoritetin prindëror) se japin pëlqimin e tyre për përdorimin e specifikuar të imazhit, zërit apo attributeve të tyre të tjera personale private dhe, sipas kërkesës, t'i dorëzojnë kopje të këtyre deklaratave Partnerëve. Partnerët duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm për ta marrë një pëlqim të tillë në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme.

3.4.4 Njoftimi mbi të drejtën e autorit

Informacioni mbi pronësinë e së drejtës së autorit duhet të përfshihet në rezultatet e komunikimit dhe vizibilitetit të veprimeve të jashtme të financuara nga Partnerët, formuluar si më poshtë: "© - viti - emri i pronarit të së drejtës së autorit. Të gjitha të drejtat të rezervuara. Licencuar Investigative Network Albania sipas kushteve".

4.RAPORTIMI

4.1 Raportimi mbi komunikimin dhe vizibilitetin

Partnerët duhet të sigurojnë që raportimi i tyre kontraktues të përmbajë një rrëfim të detajuar të zbatimit të planit të veprimit të komunikimit dhe vizibilitetit, duke vlerësuar rezultatet dhe shtrirjen e masave të komunikimit të kryera në mbështetje të veprimit, si dhe duke ilustruar vlerësimin e tyre sipas rastit, me përdorimin e artikujve të shtypi, fotografive, shembujve, skedarëve audio dhe video, transkriptimeve, etj.

Në përputhje me seksionin 3.4, partnerët duhet të sigurojnë gjithashtu, sipas seksionit 3.4, se e drejta e autorit respektohet në të gjitha materialet e përdorura për qëllime ilustrimi në raportimin e tyre.

4.2 Vizibiliteti i raporteve

Varësisht nga lloji i veprimit në fjalë, Partnerët kërkojnë lloje të ndryshme raportesh administrative që mbulojnë fazën e zbatimit të ciklit të projektit. Në të gjitha rastet kërkohet një raport përfundimtar, në shumicën e rasteve raporte të ndërmjetme / progresi, dhe në disa raste raporte fillestare. Partneriteti i përdor këto raporte për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin dhe rezultatet e veprimeve të financuara nga Partnerët.

Kërkesat e raportimit të hollësishëm (përmbajtja, frekuenca, procedurat e paraqitjes, etj.) specifikohen në kushtet e përgjithshme të të gjitha kontratave dhe mund të ndryshojnë nga veprimi në veprim, por të gjitha raportet administrative duhet të përmbajnë një kopertinë ku përmendet titulli i veprimit, referencën e kontratës, si dhe datën e dorëzimit të raportit.

Emblema e INA (seksioni 5.2) duhet të paraqitet në kopertinë. Kur përfshihen donatorë të shumtë, emblema e INA duhet të jetë të paktën po aq dukshëm e shfaqur sa edhe ato të partnerëve të tjerë financiarë dhe pozicionimi i saj në kopertinë duhet të përcaktohet në marrëveshje me ta. Emblema (emblemata) e partnerit (partnerëve) zbatues ose kontraktuesit (kontraktuesve) mund të përfshihet gjithashtu në kopertinë.

Kopertina e pasme e raportit duhet të përmbajë një deklaratë mospërgjegjësie (shih seksionin 5.3).

5.ÇËSHTJE LIGJORE

5.1 Përjashtime nga kërkesat e vizibilitetit

Përjashtimet nga detyrimet standarde kontraktuale të vizibilitetit jepen vetëm në bazë rast pas rasti. Çdo përjashtim i tillë duhet justifikuar në mënyrën e duhur dhe duhet të ketë autorizimin e mëparshëm me shkrim të Partnerëve.

5.2 Rregullat e identitetit vizual të INA

Kur emblema e INA riprodhohet në çfarëdo paraqitje grafike, ajo duhet të përdoret në tërësinë e saj, pa asnjë ndryshim apo shtesë. Shfaqja ose riprodhimi i emblemës nuk duhet të përfshijë asnjë flamur ose simbol të ndonjë vendi, donatori, agjencie ose organizate tjetër. Paraqitja grafike e çdo partneri të tillë duhet të shfaqet veçmas.

Logo e Investigative Network Albania (INA) është:



** Logo të formateve të ndryshme për përdorime të ndryshme do të vihen në dispozicion të partnerëve*

5.3 Deklaratat e mospërgjegjësisë

Partnerët dhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë nuk janë përgjegjëse për përmbajtjen e materialeve të komunikimit të përgatitura nga partnerët zbatues, të cilat duhet të përfshijnë të gjitha një deklaratë standarde mospërgjegjësie, të përkthyer në gjuhën (gjuhët) vendore, aty ku është e përshtatshme.

Për botime në format të shtypur ose elektronik:

“Ky botim u prodhua me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë dhe Partnerëve. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e <emri i autorit / partnerit> dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë dhe Partnerëve”;

Për faqet e internetit dhe llogaritë e medieve sociale:

“Kjo <faqe interneti/llogari> u krijua dhe mirëmbahet me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë dhe Partnerëve”; Përmbajtja e saj është përgjegjësi vetëm e <emri i autorit/partnerit> dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë dhe Partnerëve”.

Për videot dhe materiale të tjera audio-vizuale:

“Kjo <video / film / program / regjistrim> u prodhuan me mbështetjen financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë. Përmbajtja e saj është përgjegjësi vetëm e <emri i autorit / partnerit> dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë dhe Partnerëve”.

5.4 Vizibiliteti në strukturat me shumë donatorë

Kur donatorë të shumtë kontribuojnë financiarisht për një veprim të bashkëfinancuar nga Partnerët, partneri kryesor duhet të sigurojë që vizibilitetin të mbështetjes së Partnerëve t'i jepet të paktën rëndësi e barabartë me atë të kontribuuesve të tjerë në të gjitha materialet, evenimentet, kanalet e komunikimit, etj., të mbuluara nga këto Kërkesa.

